



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

|              |             |               |
|--------------|-------------|---------------|
| <b>Nr. 2</b> | <b>2000</b> | <b>Shkurt</b> |
|--------------|-------------|---------------|

### P Ë R M B A J T J A

|                                     |                                                                                                                                                                     | Faqe |
|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Ligj nr. 8570<br>datë 20.1.2000     | Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës<br>së<br>Shqipërisë.....<br>....                                                                      | 11   |
| Vendim i KM<br>Nr.1, datë 6.1.2000  | Për përdorimin e fondit kundërparti të bashkëfinancimit japonez<br>me projektin<br>ASAC.....                                                                        | 13   |
| Vendim i KM<br>Nr.5, datë 13.1.2000 | Për mriatimin në parim të projektit të asistencës për zgjedhjet<br>elektorale.....<br>.....                                                                         | 13   |
| Vendim i KM<br>Nr.6, datë 13.1.2000 | Për një ndryshim në vendimin nr.831, datë 28.12.1998 të<br>Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e dhënies me qira të tokës<br>bujqësore, pasuri<br>shtetërore”..... | 14   |
| Vendim i KM                         | Për masat dhe mënyrën e zbatimit të projektit “Shtimi i                                                                                                             | 15   |

Nr.7, datë 13.1.2000

prodhimeve ushqimore 2 KR, financim falas i Qeverisë  
Japoneze”.....  
.....

**LIGJ**  
**Nr. 8570, datë 20.1.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 263 ndryshohet si vijon:

**“Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit**

1. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë:

- a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

2. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

3. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

4. Në rastet kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnë përsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

5. Në rast ikje të pandehurit të paraburgosur, afatet fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai paraburgoset përsëri.

6. Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:

- a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.”

#### Neni 2

Në nenin 264 pika 2, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.”

#### Neni 3

Neni 265 ndryshohet si vijon:

#### **“Pezullimi i afateve të paraburgimit**

1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:

a) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës;

b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.”

#### Neni 4

#### **Dispozitë kalimtare**

Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, sipas këtij ligji, do të zbatohen ndaj personave që paraburgosen pas hyrjes në fuqi të tij.

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2537, datë 30.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

#### **VENDIM**

**Nr. 1, datë 6.1.2000**

#### **PËR PËRDORIMIN E FONDIT KUNDËRPADI TË BASHKËFINANCIMIT JAPONEZ ME PROJEKTIN ASAC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Pjesa e mbetur nga transhi i dytë i kredisë japoneze për projektin ASAC prej 743 774 2 mijë lekësh të përdoret nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për rimbursimin e shpenzimeve për investimet e kryera në vitin 1999.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë transaksionet e nevojshme me Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 5, datë 13.1.2000**

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROJEKTIT TË ASISTENCËS  
PËR ZGJEDHJET ELEKTORALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të vendimit nr.116, datë 24.2.1997 të Këshillit të Ministrave “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja, që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratohet në parim projekti i asistencës për zgjedhjet elektorale. 2. Ngarkohen Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Pushtetit Vendor të kërkojnë dhe të sigurojnë financimin për këtë projekt.

2. Ngarkohen Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Pushtetit Vendor të kërkojnë dhe të sigurojnë financimin për këtë projekt.

3. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor të përgatisë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 13.1.2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.831, DATË 28.12.1998, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, PASURI  
SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore, ndryshuar me ligjin nr.8406, datë 17.9.1998 , me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.831, datë 28.12.1998 të Këshillit të Ministrave, pika 1 e kreut III ndryshohet si vijon;

“Të ardhurat financiare, që sigurohen nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pasuri shtetërore, të kenë këtë destinacion: 90 për qind të arkëtohen në favor të buxhetit të shtetit dhe 10 për qind në favor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të rrethit përkatës, të cilat përdorin këto fonde për të përballuar shpenzimet e qiradhënies së tokave bujqësore, siç janë pagesat për njoftimet e ankandit në organet e shtypit dhe në radiotelevizion, përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm, dëkat, planvendosjet, kontratat, shpenzimet e noterimit, shpërblimin mr 2000 (dymijë) lekë të çdo anëtaroi të

bordit të rrethit për dhënien me qira të tokave bujqëore për çdio pjesëmarrëje në mbledhje dhe shpenzime të tjera. Në fund të çdo viti fondet financiare të pashpenzuara derdhen në buxhetin e shtetit.”.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 13.1.2000**

**PËR MASAT DHE MËNYRËN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT “SHTIMI I PRODHIMEVE  
USHQIMORE 2 KR, FINANCIM FALAS I QEVERISË JAPONEZE”**

Në mbështetje të nenit 1000 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratohen shpenzimet për implementimin e projektit, duke përdorur si burim financimi pjesë nga fondi kundërpadi i financimit falas të Qeverisë Japoneze për këtë projekt. Deri në krijimin e fondit kundërpadi përdoren, me të drejtë kthimi, fone nga Buxheti i vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Shuma e shpenzimeve për vitin 2000 do të jetë 50 (pesëdhjetë) milionë lekë.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

U dorëzua për shtyp më 1.2.2000  
Doli nga shtypi më 2.2.2000

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja ALBDESIGN sh.p.k.  
Tiranë, 2000